

---

## STATUTI

### i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar

#### "BUSHTRICA 2017"

### NENI 1

#### Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

Sot, më datë 04 Shtator 2017 ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin "BUSHTRICA 2017" SHPK.

Themeluesit e shoqërisë janë:

1. **Shoqëria "Doko" Sh.p.k.**, person juridik shqiptar i regjistruar pranë QKB me NUIS J62903324K, me seli në Bradashesh pranë Kombinatit Siderurgjik Elbasan, përfaqësuar nga Administratori i Shoqërisë **Z. Fatbardh Doko**, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me kartën e ID me nr. personal F90630170H.
2. **Shoqëria "Erniku" Sh.p.k.**, person juridik shqiptar i regjistruar pranë QKB me NUIS J71925004S me seli në sheshi Rilindja, Qendra e Biznesit Karl Topia, Kulla nr.3, Tiranë, përfaqësuar nga Administratori i Shoqërisë **Z. Iljaz Spahiu**, madhor e me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, i identifikuar me kartën e ID me nr. personal G90705104H.

### NENI 2

#### Objekti

Shoqëria ka si objekt kryesor të saj:

- Ndërtimin e Hidrocentralit mbi Lumin Bushtrica, të tipit BOT, (Ndërto-Opero-Transfero), sipas kontratës koncesionare;
- Prodhim, transmetim dhe shitje të energjisë elektrike të prodhuar nga ky hidrocentral.
- Shfrytëzimi dhe mirëmbajtja kësaj veprë hidroenergjitike përgjatë periudhës koncesionare.

---



---

**NENI 3**  
**Forma Ligjore**

- 3.1 Shoqëria ka formën e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar, në përputhje me ligjin për shoqëritë tregtare në Republikën e Shqipërisë.
- 3.2 Shoqëria ka të drejtë të hapë degë apo filiale, zyra përfaqësimi, në të gjithë vendin gjatë aktivitetit të saj.

**NENI 4**  
**Baza ligjore**

- 4.1 Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj në përputhje me këtë Statut, si dhe me Ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar me ligjin 129/2014, ("Ligji i Shoqërive Tregtare"), Ligji Nr. 125/2013 "Për Konçesionet dhe Partneritetin Publik Privat" (ndryshuar) dhe çdo dispozitë tjetër të zbatueshme të legjisllacionit shqiptar.

**NENI 5**  
**Kohëzgjatja e Veprimtarisë**

- 5.1 Shoqëria krijohet për të vepruar për 35 vjet që përputhet me kohën e përcaktuar në Kontratën e Konkensionit.

**NENI 6**  
**Selia e shoqërisë**

- 6.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: sheshi Rilindja, Qendra e Biznesit Karl Topia, Kulla nr.3, Tiranë, Shqipëri.
- 6.2 Administratori, në përputhje me kompetencat që i jep statuti mund të hapë NIPT-e sekondare të Shoqërisë që kanë lidhje vetëm me aktivitetin e përcaktuar në Nenin 2, "Objekti i veprimtarisë".

**NENI 7**  
**Kapitali themeltar**

- 7.1 Kapitali themeltar fillestar i Shoqërisë është 10.000 Lekë.
- 7.2 Kapitali themeltar do të zoterohet nga ortakët sipas sipas pjeseve takuese të mëposhtme:

- 
- a. **Shoqëria "Doko" Sh.p.k.**, zotërues i 51% të kapitalit të Shoqërisë;
  - b. **Shoqëria "Erniku" Sh.p.k.**, zotërues i 49 % të kapitalit të Shoqërisë;

## **NENI 8**

### **Zmadhimi i Kapitalit**

- 8.1 Kapitali themeltar mund të zmadhohet ose të zvogëlohet nga Asambleja e Përgjithshme me vendim unanimit të ortakëve.
- 8.2 Zmadhimi i kapitalit të Shoqërisë mund të kryhet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.  
Zmadhimi i kapitalit mund të vendoset kur e kërkojnë interesat e Shoqërisë duke vendosur kuotat suplementare të Ortakëve. Do t'u ofrohen për nënshkrim kuota të reja vetëm ortakëve ekzistues të Shoqërisë. Nëse kuotat e reja do t'u ofrohen për nënshkrim një pale të tretë atëherë duhet marre paraprakisht miratimi i ortakut tjetër.
- 8.3 Ortakët mund të financojnë shoqërinë nëpërmjet financimeve me pagesa, me interes ose pa interes, qoftë si kontribute në kapital ose jo, në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi.  
Në rastet kur shoqëria do të gjendet përballë rasteve të nevojshme për zmadhimin e kapitalit nëpërmjet financimit të ortakëve të shoqërisë, atëherë ortakët angazhohen të kryejnë financimet përkatëse.
- 8.4 Në rastin kur një ortak kundërshton parashikimin e mësipërm, atëherë asambleja e ortakëve do të procedojë me zmadhimin e kapitalit sipas parashikimeve të Ligjit, ndërkohë që ortakut që nuk merr pjesë në financim i zbritet përqindja që ai zotëron në kapitalin e shoqërisë.
- 8.5 Mënyra e rritjes së kapitalit në lidhje me metodat dhe afatet e pagimit të kontributeve nga ortakët do të vendoset rast pas rasti me vendim të Asamblesë së Ortakëve. Vendimet e Asamblesë së Ortakëve mund të përfshijnë ndër të tjera dënimet dhe pasojat për një ortak në rast të mospagesës së kontributit të rënë dakord në afatin dhe shumën e caktuar duke përfshirë, po pa u kufizuar, (i) zvogëlimin proporcional të pjesës të ortakut në Shoqërisë, (ii) shitjen e detyruar të pjesës së ortakut në Shoqëri, (iii) përcaktimit, në bazë të një vlerësimi profesional ose formule, të vlerës së cilësdo pjesë të ortakut që është paguar, dhe shitjen e detyruar të asaj pjese në vlerën e përcaktuar.

- 
- 8.6 Pavarësisht sa më sipër, zmadhimi i kapitalit nuk do të zvogëloje pjesët e interesit të ortakëve në kapitalin e shoqërisë, përveç se kur të gjithë ortakët janë dakord.

### **NENI 9** **Zvogëlimi i Kapitalit**

- 9.1 Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.
- 9.2 Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.
- 9.3 Zvogëlimi i kapitalit nuk duhet të dëmtojë kreditorët.

### **NENI 10** **Transferimi i kapitalit. Kufizimet mbi transferimin**

- 10.1 Kuotat e kapitalit të shoqërise me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
  - b) shitjes;
  - c) trashëgimisë;
  - d) dhurimit;
  - e) Çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.
- Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.
- 10.2 Nëse një ortak vdes, bashkëzotëruesit e mbetur gjallë dhe trashëgimtarët e tij janë të vetmit persona të cilët Shoqëria i njeh si titullarë të kuotës të tij; asnjë dispozitë e këtushme nuk e çliron pasurinë e ortakut të vdekur nga përgjegjësia në lidhje me kuotën që ka pasur në zotërim i vetëm ose bashkërisht.
- 10.3 Personi që fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku mundet që pas paraqitjes së instrumenteve që vërtetojnë cilësitë e qenies trashëgimtar, të vendosë ose të bëhet zotëruesi i kuotës ose të kërkojë që si zotërues i kuotës të regjistrohet një person tjetër i caktuar prej tij. Nëse vendos të bëhet zotërues vetë, ai e njofton shoqërinë në lidhje me këtë. Nëse vendos që të kërkojë që si zotërues i kuotës të regjistrohet një person tjetër, ai shfrytëzon një instrument të kalimit të kuotës te ky person tjetër.

- 
- 10.4 Personi që e fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku gëzon të drejtat, titullar i të cilave do të kishte qenë si zotërues i kuotës, me përjashtim të faktit që, përpara se të regjistrohet pranë QKR-së, ai nuk gëzon të drejtën e pjesëmarrjes ose të votës në Asamblenë e Ortakëve.
- 10.5 Transferimi i kuotave tek palët e treta ose ndërmjet ortakëve mund të bëhet vetëm me anë të një kontrate me shkrim dhe pasi të jenë plotësuar kushtet në vijim:
- 10.6 Në çdo rast tjetër të transferimit të pjesëve të kapitalit jashtë strukturës të ortakërisë, ortakët gëzojnë të drejtën e parablerjes. Ortaku i cili dëshiron të transferojë kuotën e tij do të njoftojë ortakët e tjerë nëpërmjet një njoftimi me shkrim i cili duhet të përcaktojë dhe kushtet e transferimit.
- Ortakët e shoqërisë njoftojnë qëllimin e tyre për të ushtruar të drejtën e parablerjes brenda 30 ditëve nga njoftimi. Në rast se asnjë prej ortakëve nuk ushtron të drejtën e parablerjes brenda afatit të përcaktuar më sipër, atëherë ortaku që kërkon të largohet ka të drejtë të transferojë tek të tretët kuotën e tij.
- Personi që kalon kuotën dhe ai që fiton atë përgjigjet në mënyre solidare ndaj Shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës nga çasti i kalimit të kuotave deri në çastin e regjistrimit të kalimit.

## **NENI 11**

### **Organi vendimarrës**

- 11.1 Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë.
- Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.
- 11.2 Çdo kuotë garanton të drejtën e një vote në asamblenë e përgjithshme të ortakëve ("**Asambleja e Ortakëve**"), të drejtën për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur në organet drejtuese, të drejtën për të marrë pjesë në shpërndarjen e fitimit të Shoqërisë si dhe të drejtat e siguruara nga ky Statut, marrëveshjet midis ortakëve dhe parashikimet e Ligjit Tregtar.
- 11.3 Vetëm Asambleja e Ortakëve do të ketë të drejtë të vendosë për çështjet e mëposhtme:
- a. Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
  - b. modifikimin dhe ndryshimin e këtij Statuti;
  - c. të vendosë për emërimin dhe shkarkimin e administratorëve të Shoqërisë;

- 
- d. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
  - e. të zmadhojë dhe/ose zvogëlojë kapitalin e regjistruar;
  - f. vendosë për shkrirjen, prishjen, likuidim dhe çdo lloj transformimi tjetër të Shoqërisë;
  - g. emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - h. të themelojë dhe/ose mbyll degë dhe përfaqësi jashtë dhe brenda Shqipërisë;
  - i. të miratojë raportet vjetore, pasqyrat financiare dhe shpërndarjen ose jo te fitimit;
  - j. përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - k. të vendosë mbi blerjet, shitjet dhe hipotekimin/pengut mbi pasuritë e shoqërisë;
  - l. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë ;
  - m. të vendosë pagën e Administratorit;
  - n. të vendosë për caktimin e ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - o. të vendosë mbi organizimin strukturor dhe administrativ të Shoqërisë;
  - p. të vendosë mbi buxhetin vjetor;
  - q. mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - r. të vendosë marrjen e huave apo dhënien e garancive nga Shoqëria;
  - s. të vendosë për çdo çështje tjetër, që i takon për zgjidhje asamblesë së ortakëve, me ligj dhe/ose sipas këtij statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi, nga një ortak i shoqërisë apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

## **NENI 12**

### **Vendimet e Asamblesë së Ortakëve**

- 12.1 Vendimet, të listuara më sipër, në lidhje me ndryshimin e këtij Statuti, zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit, shpërndarjen e fitimit, marrjen e huave apo dhënien e garancive nga Shoqëria, organizimin dhe shpërndarjen e Shoqërisë kërkojnë vendimin unanimit të ortakëve të shoqërisë, në bazë të kërkesave të kuorumit të parashikuara në Nenin 14 më poshtë ("**Vendime**

---

**unanime**”). Të gjitha vendimet e tjera të Asamblesë së Ortakëve mund të miratohen me shumicë të cilësuar prej 75% të ortakëve të shoqërisë, në bazë të kërkesave të kuorumit në Nenin 14 më poshtë ("**Shumicë e Cilësuar**"). Vendimet e Asamblesë së Ortakëve për caktimin e administratorit miratohen me Shumicë të cilësuar.

### **NENI 13**

#### **Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve**

- 13.1 Asambleja e Ortakëve do të thirret nga Administratori i Shoqërisë nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, me njoftim nëpërmjet postës elektronike të paktën një herë në vit në selinë e Shoqërisë ose në çdo vend tjetër të përcaktuar në njoftim brenda gjashtë muajve të parë të çdo viti kalendarik për të miratuar pasqyrat financiare të Shoqërisë të vitit të mëparshëm financiar.
- 13.2 Asambleja e përgjithshme thirret nga Administratori edhe nëse,
  - a. sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e Shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
  - b. Shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të Shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
  - c. Shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të Shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- 13.3 Më tej, anëtarët që përfaqësojnë të paktën 5% të votave të përgjithshme të Shoqërisë mund t'i kërkojnë administratorit me shkrim apo me postë elektronike thirrjen e asamblesë së ortakëve. Kërkesa duhet të mbajë arsyet dhe objektivat dhe çështjet për të cilat asambleja e ortakëve duhet të vendosë.
- 13.4 Asambleja e Ortakëve do të thirret me njoftim me shkrim të lëshuar nga administratori, i cili duhet t'u dërgohet përfaqësuesve të ortakëve me letër rekomande ose faks ose postë elektronike (e-mail) jo më vonë se 7 (shtatë) ditë përpara ditës së caktuar për asamblenë. Njoftimi për ortakët duhet të përcaktojë datën, orën dhe vendin e mbledhjes së asamblesë si dhe çështjet për t'u diskutuar (rendi i ditës) dhe, në rast të një asambleje të zakonshme të ortakëve, duhet të përfshijë pasqyrat e plota financiare dhe raportin e administrimit.
- 13.5 Çdo ortak ka të drejtë të përfaqësohet nga një person tjetër në përputhje me nenin 85 të Ligji të Shoqërive Tregtare.

---

## **NENI 14**

### **Vendimet e miratuara në Asamblenë e Ortakëve, Kuorumi**

- 14.1 Në rastin e vendimeve të miratuara unanimit nga të gjithë ortakët, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse janë prezent të gjithë ortakët e shoqërisë.
- 14.2 Në rastin kur Asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje të cilat kërkojnë Shumicë të kualifikuar, Asambleja e Ortakëve mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse janë prezent ortakët që zotërojnë mbi 75% të kuotave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike.
- 14.3 Nëse Asambleja e Ortakëve është e mbledhur në mënyrë korrekte, por numri i kërkuar i ortakëve për të plotësuar kuorumin nuk është prezent apo nuk është i përfaqësuar, asambleja e ortakëve do të mblidhet sërish në përputhje me parashikimet e Nenit 14 por jo më vonë se 30 ditë. Rendi i ditës i asamblesë së dytë nuk do të ndryshojë.
- 14.4 Kur Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve nuk është thirrur sipas formaliteteve të ligjit ose këtij statuti, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë të pranishëm dhe shprehen dakord për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.
- 14.5 Ortakët kanë të drejtën, që u njihet nga ligji apo statuti, për të marrë unanimitisht çdo vendim, me kusht që ai të formalizohet me shkrim.
- 14.6 Asambleja e përgjithshme vendos me vendim unanimit të ortakëve për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

## **NENI 15**

### **Procesverbalet e Asamblesë së Ortakëve**

- 15.1 Të gjitha vendimet e Asamblesë së Ortakëve duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratori përgjigjet për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve. Procesverbali duhet të përmbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit si dhe ti bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së asamblesë së përgjithshme.
- 15.2 Procesverbali i Asamblesë së Ortakëve nënshkruhet nga ortakët dhe nga mbajtësi i procesverbalit. Asambleja e Ortakëve mund të vendosë që procesverbali të mbahet nga një noter publik në të cilin rast nuk është e nevojshme caktimi i mbajtësit të procesverbalit dhe nënshkrimi i

---

procesverbalit nga kryetari i mbledhjes. Ekstraktet e procesverbalit të Asamblesë së Ortakëve për qëllim depozitimi në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit janë të vlefshme nëse nënshkruhen nga të gjithë ortakët pjesëmarrës në Asamblenë e Ortakëve ose nga Administratori i Shoqërisë.

## **NENI 16**

### **Përfashtimi nga e drejta e votës**

- 16.1 Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse Asambleja e Ortakëve merr vendime për:
- a. vlerësimin e veprimtarisë së tij;
  - b. shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
  - c. ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
  - d. dhënien ose jo të përfitimeve të reja;
- dhe çdo rast tjetër të parashikuar në Ligjin për Shoqëritë Tregtare.
- 16.2 Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

## **NENI 17**

### **Administrimi i Shoqërisë dhe kompetencat e administratorit**

- 17.1 Shoqëria do të administrohet nga një administrator i vetëm, i emëruar në përputhje me këtë statut.
- 17.2 Administratori i Shoqërisë mund të shkarkohet nga pozicioni që ka në Shoqëri në çdo kohë nga Asambleja e Ortakëve me Shumicë të Cilësuar. Në çdo rast janë ortakët ata të cilët vlerësojnë se ka shkaqe të arsyeshme për shkarkimin e administratorit
- 17.3 Administratori ka të drejtë të përfaqësojë Shoqërinë në mënyrë të plotë për administrimin e zakonshëm të saj si edhe të drejtën për të miratuar të gjitha vendimet që i gjykon të përshtatshme për arritur dhe përmbushur qëllimin e shoqërisë, me përjashtim të vendimeve që me ligj i takojnë Asamblesë së Ortakëve.

Administratori mund të autorizojë palë të treta për ta përfaqësuar atë në transaksione të veçanta me anë të një prokure të hartuar para noterit.

---

17.4 Personi i mëposhtëm do të caktohet si Administrator i Shoqërisë për një afat **5 vjeçar**:

**Z. Iljaz Spahiu**, shtetas shqiptar, lindur më 05.07.1969 në Kukës dhe banues në Tiranë, Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit nr.personal G90705104H.

Të drejtat dhe detyrimet e Administratorit janë ato të përcaktuara në Ligjin e Shoqërive Tregtare, këtë Statut, vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve dhe rregullat e brendshme të administrimit të Shoqërisë.

17.4 Administratori ka të drejtat dhe detyrimet e mëposhtme:

- a. përfaqësimin e Shoqërisë kundrejt palëve të treta dhe shtetit;
- b. hapjen e llogarive bankare të Shoqërisë me bankat;
- c. përfundimin e marrëveshjeve me palët e treta, lëshimin dhe marrjen e urdhër pagesave, pas miratimit me shkrim nga ortaket;
- d. nënshkrimin e të gjithë dokumenteve, lëshimin e faturave, transferimet në monedhë të huaj, fletë ngarkesat etj, pagimin e detyrimeve të Shoqërisë dhe pranimin e letrave me vlerë nga palët e treta;
- e. mbledhjen e detyrimeve që i takojnë shoqërisë;
- f. punësimin dhe shkarkimin e stafit të Shoqërisë, përcaktimin e pagave, shpërblimeve dhe pagesave të stafit, pas miratimit me shkrim nga ortaket;
- g. marrjen e masave paraprake për mbrojtjen e interesave të Shoqërisë, ngritjen e padive dhe marrjen përsipër të mbrojtjes së Shoqërisë në rast të padive kundër saj; administratori mund të udhëzojë avokatët të mbrojnë Shoqërinë dhe mund të përcaktojë shumën e shpërblimit të tyre me miratimin paraprak të Asamblesë së Ortakëve;
- h. administratori ka të drejtë të ngrejë padi dhe t'i tërheqë ato, të nënshkruajë marrëveshje gjyqësore, të mbyllë marrëveshje arbitrazhi, të caktojë arbitra, të tërheqë paditë e ngritura nga Shoqëria dhe të ndërpresë procedimet por në cdo rast përpara kryerjes së ndonjë prej veprimeve të mësipërme, administratori duhet të marrë miratimin e Asamblesë së Ortakëve.
- i. ndërmarrjen e të gjithë veprimeve të tjera që i takojnë aktivitetit të përditshëm të Shoqërisë nga pikëpamja e ligjit dhe këtij Statuti;
- j. mbajtjen e llogarive në përputhje me ligjin dhe parimet e kontabilitetit;
- k. përgatitjen e pasqyrave vjetore financiare të Shoqërisë dhe kontrollin e tyre nga auditorë të jashtëm nëse kjo kërkohet nga ligji ose nga një vendim i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve;
- l. thirrjen e mbledhjeve të Ortakëve; përcaktimin e rendit të ditës; monitorimin e përmbushjes së dispozitave që kanë lidhje me thirrjen dhe

- 
- drejtimin e mbledhjes së përgjithshme të Ortakëve për shpalljen e vendimeve përkatëse;
- m. të vendosë në dispozicion të Ortakëve të Shoqërisë sa herë që të kërkohet prej tyre informacionet, raportet dhe dokumentet në lidhje me shpenzimet e Shoqërisë, gjendjen e llogarive bankare, inventarin, deklarata për të hyrat, deklarata të tjera financiare, fletëparaqitjet tatimore të Shoqërisë dhe auditet, nëpërmjet formës së kërkuar dhe njoftuar nga secili Ortak, si p.sh. nëpërmjet faxit, postës elektronike apo postës së zakonshme.
- n. Administratori është i detyruar të therrasë asamblenë e përgjithshme të Ortakëve në rastet kur:
- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare rezultojnë ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
  - shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
  - shoqëria brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- o. kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të Shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- p. përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- q. çdo detyrë tjetër të parashikuar në ligj.

## **NENI 18**

### **Viti Financiar dhe Dividendi**

- 18.1 Viti Financiar i aktivitetit të Shoqërisë përkon me vitin kalendarik, fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor të çdo viti. Përbërësimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet më datë 31 Dhjetor.
- 18.2 Pas përcaktimit të fitimit të Shoqërisë në përpunje me pasqyrat financiare dhe pas përmbushjes së kërkesave së nenit 77 të Ligjit për Shoqëritë

---

Tregtare, fitimi i Shoqërisë, deri sa të shlyhet shuma e investimit fillestar, ndahet midis ortakëve sipas përqindjes së tyre në shoqëri.

### **NENI 19**

#### **Eksperti(ët) Kontabël të Autorizuar**

- 19.1 Eksperti(ët) Kontabël i Autorizuar do të emërohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve, nëse është e nevojshme.
- 19.2 Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.
- 19.3 Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

### **NENI 20**

#### **Bilanci, Mbajtja e Llogarisë**

- 20.1 Bilanci i Shoqërisë kontrollohet nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve dhe duhet të përgatitet për t'ju paraqitur organeve tatimore përpara përfundimit të muajit mars të vitit pasues.
- 20.2 Librat e llogarisë duhet të mbahen në gjuhën shqipe dhe në monedhën vendase (Lek). Shoqëria mund të mbajë llogari të veçanta në monedhë të huaj, shuma e të cilave duhet të konvertohet, çdo muaj, në monedhën vendase.
- 20.3 Shoqëria mund të marrë financime nga institucione financiare që operojnë në Shqipëri ose jashtë saj. Për këtë arsye Shoqëria mund të vendosë barrë siguroese mbi kuotat si garanci, ose mund të hipotekojë pasurinë e paluajtshme të saj, me vendim të Asamblesë së Ortakëve të marrë me Shumicë të Cilësuar.

### **NENI 21**

#### **Prishja dhe likuidimi**

---

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë nga Asambleja e Ortakëve me Shumicë të Cilësuar:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblesë së ortakëve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë ;
- e) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej shoqërisë emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë " Shoqëri në likuidim e sipër".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesi i emëruar nga Ortakët.

Nëse Ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesit, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Likuiduesi(t) do të përgatisin raportin e likuidimit, i cili përmban një përmbledhje të gjendjes ekonomike të Shoqërisë, hapat e likuidimit dhe kohën e nevojshme për përfundimin e tij. Në fund të këtij procesi, Asambleja e Ortakëve do të kontrollojë bilancin përfundimtar dhe do të japë miratimin për përfundimin e procedurës së likuidimit.

## **NENI 22**

### **Largimi dhe përjashtimi i Ortakut**

Largimi dhe përjashtimi i ortakut do të kryhet në përputhje me nenet 101, 102 dhe 103 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

---



---

**NENI 23**  
**Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas vendimit të mbledhjes së përgjithshme të asamblesë së ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" ( i ndryshuar).

**NENI 24**  
**Marrëdhëniet e punës**

Marrëdhëniet e punës rregullohen nëpërmjet kontratës së punes dhe legjislacionit të punës në fuqi. Shoqëria merr përsipër të respektojë rregullat në fuqi të punësimit dhe të punësuarit janë të detyruar që të respektojnë Statutin e kësaj Shoqërie dhe rregullat e brendshme të saj. Të punësuarit duhet të përgjigjen për dëmet që i shkaktojnë kësaj Shoqërie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.

**NENI 25**  
**Ndryshimet në Statut**

Dispozitat e këtij Statuti mund të ndryshohen nga Asambleja e Ortakëve, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare.

**NENI 26**  
**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

---



---

**NENI 27**  
**Dispozita Kalimtare dhe të fundit**

Ky Statut u redaktua ne 4 ekzemplare me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhën shqipe, u miratua në parim nen per nen nga Ortakët e shoqërisë tregtare "**Bushtrica 2017**" sh.p.k., nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën orgjinale.

**ORTAKËT**  
**E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**" BUSHTRICA 2017" sh.p.k.**

**Shoqëria "Doko" shpk**

Z. Fatbardh Doko



**Shoqëria "Erniku" shpk**

Z. Iljaz Spaniu

